

BREAKING NEWS

x

MINISTRIA PUBLIKON BILANCIN, JA SA RASTE TE REJA JANE SHENUAR 24 ORET E FU...

AKTUALITET

Konflikti për pronën, plagoset me armë gjahu pronari i furrës së bukës në Kavajë, arrestohet 26-vjeçari

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
16 MARS 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Një 60-vjeçar, ka mbetur i plagosur mëngjesin e djeshëm në qytetin e Kavajës. I moshuari është qëlluar me armë zjarri nga një 26-vjeçar, në ambientet e biznesit së tij. Mësohet se Esat Kotorri 60-vjeç, është qëlluar nga Seferian Troka, në ambientet e biznesit së tij. Ngjarja ka ndodhur në ambientet e biznesit të 60-vjeçarit, në një

furrë buke në orët e para të mëngjesit. Sipas policisë mësohet se i riu ka qëlluar ndaj Kotorrit pas një konflikti pronësie që ata kanë pasur mes tyre. Ishte ora 05:00 e mëngjesit kur Troka ka hyrë në furrën e bukës, ku 60-vjeçari, ishte duke punuar me çifte në dorë dhe ka qëlluar dy herë në drejtim të tij. Pas ngjarjes punëtorët e furrës së bukës kanë lajmëruar policinë e cila ka mbërritur menjëherë në vendin e ngjarjes dhe kanë transportuar në spital të plagosurin. Kotorri fillimisht është dërguar në spitalin e Kavajës, ku pas marrjes së ndihmës së parë mjekësore është transportuar drejt Spitalit të Traumës për mjekim më të specializuar. Burime spitalore bëjnë me dije se 60-vjeçari ndodhet nën kujdesin e mjekëve jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë, policia menjëherë pas ngjarjes mori në pyetje personat që ishin në ambientet e furrës kur ndodhi ngjarja. Kanë qenë punonjësit të cilët kanë bërë të mundur identifikimin e autorit dhe i kanë treguar policisë mbi identitetin e tij. Menjëherë policia u vu në lëvizje, ku rreth 1 orë e gjysmë pas ngjarjes bëri të mundur kapjen dhe arrestimin e kësaj ngjarje të rëndë, e cila fatmirësisht përfundoi pa viktima. Ndërkohë, burime thanë për gazetën “Sot” se familje Kotorri dhe Troka janë në një konflikt pronësie bashkë. Mësohet se mbrëmjen e së enjtes përpara se të ndodhte ngjarja ata kanë pasur një sherr mes tyre, ku pas sherrit Seferian Troka, ka hyrë në furrën e Esat Kotorrit dhe ka qëlluar me çifte në drejtim të tij duke e plagosur. Mbi autorin, tashmë të arrestuar rëndon akuza e “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”,

Policia


Ka qenë policia e kryeqytetit e cila mëngjesin e djeshëm dha detaje për ngjarjen e rëndë në qytetin e Kavajës, ku mbeti i plagosur pronari i furrës së bukës në këtë qytet. Sipas policisë së kryeqytetit ka qenë një konflikt pronësie i cili ka degjeneruar deri në përdorimin e armëve, por fatmirësisht pa viktima. Zyrtarisht policia tha se pas plagosjes së 60-vjeçarit, Shërbimet e Policisë Kavajë,

identifikuan, kapën dhe arrestuan në kohë rekord shtetasin Seferian Troka 26 vjeç. Në komunikatën e shpërndarë për mediat policia tha se ngjarja ka ndodhur rreth orës 05.15 të mëngjesit të djeshëm, në qendër të qytetit të Kavajës. Rreth orës 05:15 të mëngjesit të së premtes, në qytetin e Kavajës në ambientet e një furre buke, për shkak të një konflikti pronësie është plagosur me armë gjahu pronari i një furre buke, shtetasi Esat Kotorri 60 vjeç, i cili ndodhet në spital nën kujdesin mjekësor. Si autor i ngjarjes, policia ka identifikuar një 26-vjeçar me inicialet S. T., i cili u arrestua nga uniformat blu. Materialet i kaluan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë në ngarkim të shtetasit S. T., për veprën penale “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të Kodit Penal”, sqaroi zyrtarisht policia pas zbardhjes së ngjarjes dhe kapjes së autorit.

Elvis Myrta

YOU MAY LIKE

by mgid



Već za 5 dana krvni sudovi će ponovo biti kao sa 25 godina!

HYPERTEA